



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1261 / Prot
4

Tiranë, më 7 / 11 / 2013

URDHËR

Nr. 18 datë 07 / 11 / 2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Nobis Wellnes Center".

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 216 datë 10.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Nobis Wellnes Center" me adresë, Rr. "Sami Frasheri", Kompleksi TID, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).
- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale/sensitive dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave (nenet 5-9 dhe 12-16).
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale/sensitive dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues dhe vendosën në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi "Nobis Wellnes Center" ofron aktivitete dhe kurse noti, gjimnastike në ujë, fitnes, shërbime estetike (trajtim trupi dhe fytyre), SPA (sauna, hidromasazh, etj), shërbime

restoranti dhe parukerie. Gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë klientë dhe punonjës.

Për kategorinë "klient" gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si: *emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, fotografia, gjinia, mosha, numri i telefonit, adresa e banimit, numri i kartës së identitetit, profesioni, gjendja civile*. Këto të dhëna mblidhen nga personeli i Nobis (receptioni), në mënyrë elektronike, nëpërmjet plotësimit të një karteje elektronike në një program/sistem të posaçëm për veprimtari të tilla. Klientët janë persona madhorë ose të mitur. Të miturit shoqërohen nga prindërit dhe të dhënat merren prej tij.

Bazuar në deklaratimet e përfaqësuesit të kontrolluesit dhe nga vëzhgimi në terren u konstatua që pavarësisht faktit që programi parashikonte mundësinë e hedhjes së kategorive të mësipërme të të dhënave, përpunoheshin vetëm të dhëna të tilla si: *emri, mbiemri, gjinia, vendlindja, datëlindja, fotografia, mosha, numri i telefonit, adresa e banimit, numri i kartës së identitetit*.

Për përdorimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e mirëfunksionimit të Nobis, është kontraktuar një kompani italiane e cila ofron konsulentë e saj në këtë fushë. Kompania nuk ka akses në të dhënat në sistem por kontrata përmban në nenin 6 të saj edhe detyrimin e kompanisë konsulente për të ruajtur konfidencialitetin.

Kontrolluesi mbledh edhe të dhëna nëpërmjet përdorimit të sistemit të video-survejjimit të instaluar për të vëzhguar ambientet e brendshme të Nobis.

Për kategorinë "punonjës" kontrolluesi mbledh të dhëna personale si: *emri, mbiemri, data e lindjes, vendlindja, numrin e librezës së punës, gjendja civile, arsimi, raport mjekësor, kualifikime*. Këto të dhëna administrohen në "Dosjen personale të punonjësit", bazuar në legjislacionin e punës.

Të dhënat personale të klientëve dhe punonjësve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për klientët është vetëm ofrimi i shërbimeve nga Nobis. Ndërsa qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për punonjësit lidhet me mbarëvajtjen e punës në kuadër të zbatimit të legjislacionit përkatës në këtë fushë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, meqenëse kontrolluesi "**Nobis Wellnes Center**", gjatë veprimtarisë mbledh dhe përpunon të dhëna nëpërmjet përdorimit të sistemit të video-survejjimit, për të cilat nuk ka njoftuar (në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar), atëherë lind nevoja e përditësimit të njoftimit të kryer më parë.

Komisioneri vlerëson si të drejtë përpunimin e fotografisë së klientit dhe hedhjes në sistem, pasi, bazuar edhe në deklaratimet e përfaqësuesit të kontrolluesit, kjo bëhet për të shmangur abuzimet në hyrjen e personave të pa abonuar në ambientet e Nobis dhe për të ndihmuar receptionin për të identifikuar personin e abonuar.

Sa i përket respektimit të parimit të mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit në përpunimin e të dhënave personal të klientëve, Komisioneri vlerëson se se përpunimi i të dhënave të tilla si numri i kartës së identitetit dhe adresës së banimit është në tejkalim të qëllimit, i cili ka të bëjë thjesht me ofrimin e shërbimeve të përmendura më sipër, dhe konsiderohen si të tepërta.

Të dhënat personale të klientëve mbahen në sistem për një afat të pacaktuar. (fshihen vetëm me kërkesën në formë shkresore të klientit). Të dhënat personale të punonjësve të larguar mbahen në dosjet e tyre të punës për një afat të pacaktuar. Komisioneri vlerëson se në kuadër të zbatimit të nenit 5 (shkronja d), të dhënat mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Në kuadër të zbatimit të nenit 6 të ligjit, kontrolluesi merr pëlqimin e klientëve për përpunimin e të dhënave të tyre personale nëpërmjet disa tipe deklarata. Komisioneri vlerëson se pëlqimi i klientit nuk jepet në formë të qartë. Klientëve nuk u jepet mundësia të refuzojnë dhënien e të dhënave pasi në rast të kundërt nuk mund të aksesojnë shërbimet (psh: nuk mund të refuzojë të japë fotografinë).

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve e të punonjësve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi disponon një program të posaçëm në kompjuter të cilin e përdor me qëllim regjistrimin e klientëve dhe krijimit të raporteve statistikore lidhur me veprimtarinë e qendrës. Ky sistem aksesohet nga punonjësit e recepsionit, administratori dhe specialisti i IT, të cilët janë të pajisur me “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalimin” përkatës në mënyrë të personalizuar. Për çdo klient në program hapet një ndërfaqe e re, ku një operator i kontrolluesit regjistron fillimisht të dhënat identifikuese që i kërkon klientit. Gjithashtu janë marrë të gjitha masat e sigurisë fizike të ambienteve.
- Databaza e krijuar nga regjistrimet përmes programit të menaxhimit të klientëve, ruhet në *serverin* e vendosur brenda ambienteve të kontrolluesit. Pra të dhënat nuk ruhen lokalisht në kompjuterat e operatorëve. Gjithashtu pas regjistrimit, rekordi i klientit nuk mund të fshihet apo ndryshohet nga operatorët por vetëm nga administratori sistemit. Aksesin në server e ka specialisti IT, i cili në rast defektesh apo përmirësimesh në program i mundëson akses *remote* kompanisë italiane që mirëmban programin.
- Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve (cituar më sipër), ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit.

Në kuadër të përpunimit ligjor të të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (referuar Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi ka instaluar 16 kamera brenda ambienteve të tij. Aksesit në të dhëna është i kufizuar vetëm për menaxherin dhe specialistin IT. Kamercat janë fikse dhe me zmadhim të kufizuar. Filmimet mbahen për një periudhë prej 26 ditësh dhe fshihen automatikisht.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejjimit.
- Në ambientet e survejuara me kamera nuk ka tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejjimit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

URDHËROJ

1. Në zbatim të shkronjës c) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të dhënat e klientëve mbi numrin e kartës së identitetit dhe adresës së banimit të fshihen nga sistemi/kompjuteri pasi janë të tepërta dhe në tejkalim të qëllimit të përpunimit. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.
2. Në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve që u ka mbaruar abonimi për të frekuentuar "Nobis Wellnes Center", të fshihen nga sistemi/kompjuteri, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.
3. Të dhënat e punonjësve të administruara në dosje, të shkatërrohen pas përfundimit të marrëdhënies së punës (në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit dhe Udhëzimit nr.11, datë 08/09/2011 mbi "Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat").
4. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, në çdo rast, të merret në formë shkresore pëlqimi i klientëve, për mbledhjen dhe përpunimit të të dhënave të tyre personale, veçanërisht për fotografitë e tyre.
5. Në zbatim të nenit 18 të ligjit, kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre.

6. Në zbatim të nenit 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:
- Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruara nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
 - Në ambientet e survejuara me kamera të vendosen tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.
7. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
8. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
9. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

